U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

American Spaces

BEYOND BARRIERS
We believe in what we do

# MOBILE JOURNALISM– FROM CORNERS TO CITIES



## 3 arsye përse të bëheni pjesë e Outdoor Ambassadors – eksperienca ime

BLOG
SHKRUAJTUR NGA: Dea Haskaj

Si të gjithë të rinjtë në periudhën post-pandemisë edhe unë doja që t'i riktheheshа jetës sime normale dhe përditshmërisë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë ishte të bëhesha pjesë e një grupi me të rinj aktivë. Fushatat e tyre, takimet apo aktivitetet e ndryshme në natyrë më ndihmuan shumë.

Di të them që si unë ishin dhe janë shumë të tjerë që nuk dinë apo nuk kanë si ta shpenzojnë kohën e tyre. Prandaj, po ju jap tri arsye se përse duhet të na bashkoheni në Outdoor Ambassadors.

1) Outdoor Ambassadors të jep mundësinë të zbulosh pikat e tua të forta dhe të dobta si dhe të punosh më tepër për t'i rregulluar ato
2) Të nxit të socializohesh e të kuptosh më tepër veten tënde në raport me të tjerët
3) Vullnetarizmi të ndihmon të ndihesh mirë dhe ta njohësh më tepër veten tënde.

Mendoj se këto janë arsyet kryesore për t'u bërë pjesë e Outdoor Ambassadors, por nuk do të thotë që nuk ka të tjera. Takohemi në Corner!